

Në bazë të nenit 4, nenit 5 dhe nenit 6 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programet, projektet dhe aktivitetet nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit, nr. 08-1828/1 të datës 13.02.2026 dhe në lidhje me Programin për financimin e institucioneve publike nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit“ nr. 14/25), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për ndarjen e mjeteve financiare
për realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e
kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026

I

Lëndë e thirrjes publike është financimi i programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026.

II

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë persona fizikë që banojnë në territorin e Qytetit të Shkupit (artistë dhe artistë të pavarur) të cilët kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në përputhje me Ligjin për kulturë dhe dispozita të tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë edhe personat juridikë që kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në territorin e Qytetit të Shkupit (institucione nga fusha e kulturës, shoqata civile, fondacione dhe subjekte të tjera juridike të cilat janë të regjistruara në Regjistrin qendrorë të RMV-së), në përputhje me Ligjin për kulturë dhe dispozitat e tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

III

Thirrja publike ka të bëjë me financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve në bazë të qëllimeve dhe kriterëve të përcaktuara për përzgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit në këto fusha:

- 1.1. Arte performuese
- 1.2. Arte muzikore
- 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
- 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
- 1.5. Veprimtari muzeore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar
- 1.7. Industri kreative

IV

Aplikantët janë të obliguar të depozitojnë aplikimin për financimin e projekteve/programeve/aktiviteteve në përputhje me fushat e lartpërmendura dhe në përputhje me qëllimet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit të dhëna si shtojca në këtë thirrje publike.

Fletëparaqitjet (aplikimet) mund të shkarkohen nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Të bashkëngjitur me aplikimin, aplikantët janë të obliguar të sigurojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

Subjekte juridike – institucione nga fusha e kulturës, shoqata civile, organizata joqeveritare, fondacione dhe persona të tjerë juridikë duhet të dorëzojnë:

- a) Fletëparaqitje/aplikim i plotësuar (aplikim do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- b) Kopje të Aktvendimit për regjistrim në Regjistrin qendrorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- c) Kopje e Gjendjes aktuale për veprimtarinë e regjistruar jo më e vjetër se gjashtë muaj, e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.;
- ç) Vërtetim për xhiro-llogari të hapur dhe aktive në bankë;
- d) Lista e referencës për programet, projektet, aktivitetet dhe manifestimet programore të organizuara dhe të realizuara më parë në tre vitet e fundit.

Persona fizikë – artistë dhe artistë të pavarur duhet të dorëzojnë:

- a) Fletëparaqitje/aplikim i plotësuar (aplikim do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- b) Biografi e shkurtër dhe CV e aplikantit;
- c) Dëshmi për vendbanim në qytetin e Shkupit;
- ç) Kopje e faqes së përparme të llogarisë së transaksionit (vetëm personale e aplikantit, jo e autorizuar nga një palë e tretë, dhe nëse aplikanti është i mitur, llogaria e transaksionit duhet të jetë vetëm personale e aplikantit e autorizuar nga prindi/kujdestari).

Aplikimi i plotësuar detyrimisht në mënyrë elektronike dhe i nënshkruar nga aplikanti (për persona juridikë edhe i noterizuar/shtypur), së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në arkivin e Qytetit të Shkupit ose me postë në adresën: bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, jo më vonë se ora 15:00 e ditës së fundit të theksuar në thirrjen publike, në zarf të mbyllur me shënimin: Deri te Sektori për Veprimtari Publike – Komisioni për programe, projekte dhe aktivitete nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit.

VI

Mjetet për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të aplikantëve janë parashikuar me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

VII

Thirrja publike zgjat 25 ditë të kalendarit nga dita e shpalljes në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk, deri në ditën e fundit në orën 15:00.

Vërejtje: Aplikimet e plotësuara në mënyrë manuale fare nuk do të shqyrtohen.

Në bazë të fletëparaqitjeve (aplikimeve) të pranuara në pajtim me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2026, në varësi nga mjetet në dispozicion dhe nevojat e Qytetit, Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, do të miratojë Aktvendim për financimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën e kulturës.

Aplikuesit e përzgjedhur do të lidhin kontratë me Qytetin e Shkupit, me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

Për aplikimet që nuk janë pranuar, Komisioni do të njoftojë aplikantët.

Aktvendimi për financimin e projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës për vitin 2026 do të shpallet në ueb faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk në afatin prej 45 ditëve pas përfundimit të Thirrjes publike.

Informacione plotësuese mund të merren në numrat e telefonit: 02/3297-289, 02/3297-243 dhe në adresën e-mailit: kultura@skopje.gov.mk.

Qyteti i Shkupit